

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtarja e vetme gjyquese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.424-6/2016 të datës 06.12.2016, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënpar.3.1 të KP-së, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Musli Gashi dhe të akuzuarit, me datë 01.11.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

#### I akuzuari:

A. B., nga i ati H. dhe e ëma F., e vajzërisë Susuri, i lindur më [ ] në Prizren, ku dhe tani jeton në rrugën " " pa nr., ka të kryer shkollën e fillore, puntor në ndërtimtari, i martuar, i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [ ]

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 01.03.2016, rreth ores 08:45 minuta, në Prizren, për derisa e dëmtuara E. B. ishte në një lokal në afërsi të shkollës e shoqëruar nga një shok dhe shoqe, i akuzuari A. B. shkon në atë lokal dhe në mënyrë të dhunëshme e kap për flokë dhe e sulmon me shuplaka dhe largohet nga lokali, me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje në kokë, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.M. G. të datës 03.08.2016.

-Këso dore ka kryen veprën penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënpar.3.1 të KP-së.


Andaj gjykata në bazë të nenit të lartëcekur dhe neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara E. (A.) B. nga Prizreni, rr. p.nr. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari A. B. obligohet që t' i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20 € euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.



-Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës-dega në Prizren, që të bëjë mbikqyrjen e dënimit me kusht.

-Urdhërohet i akuzuari A. B. që të mbajë kontaktet me SHSK-dega në Prizren.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.424-6/16 të datës 06.12.2016, kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënpar.3.1 të KP-së.

Në shqyrtimin fillestar, i akuzuari A. B. ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. B., me datë 01.03.2016, rreth ores 08:45 minuta, në Prizren, për derisa e dëmtuara E. B., ishte në një lokal në afërsi të shkollës e shoqëruar nga një shok dhe shoqe, i akuzuari A. B., shkon në atë lokal dhe në mënyrë të dhunëshme e kap për flokë dhe e sulmon me shuplaka dhe largohet nga lokali, me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje në kokë, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. M. G. të datës 03.08.2016.


Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari A. B., i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat e propozuara në aktakuzë. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, rrethanat personale të tij, se është familjar, baba i dy fëmijve dhe mbajtës i vetëm i familjes, se të dëmtuarën e ka vajzë dhe është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kështu që nga rrethanat e lartëcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe se në të ardhmen të akuzuarin do ta parandalojë në kryerjen e veprave penale dhe se ky lloji i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.



Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2672/16, me datë 01.11.2017**

**Procesmbajtësja**  
Luljeta Luboteni



**UDHËZIM JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimt të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.